

GJYKATA E APELIT

Numri i lëndës: PAKR 542/14

Data: 20 korrik 2015

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati, kryetare e kolegjit dhe gjyqtare raportuese, dhe gjyqtarëve kosovar Xhevdet Abazi e Tonka Berishaj si anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e Anne-Gaëlle Denier, zyrtare ligjore e EULEX-it, në cilësinë e procesmbajtëses,

në procedurën penale kundër

Z.V., emri i të atit [], emri i nënës [], i lindur më [] në [], serb i Kosovës, i arrestuar më 29 korrik 2013, nga kjo datë në paraburgim deri më 28 shkurt 2014, në arrest shtëpiak nga 28 shkurt 2014 deri më 20 qershor 2014 dhe nga kjo datë nën masën e paraqitjes në stacionin e policisë deri më 10 korrik 2014;

i akuzuar me aktakuzën e ngritur pranë gjykatës nga Zyra e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë nr. PP. 157/2013 më 25 tetor 2013 për këtë veprë penale: **Vrasje e rëndë në tentativë** sipas nenit 147(10) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (tash e tutje “KPPK”, në fuqi nga data 6 prill 2004 deri më 31 dhjetor 2012), lidhur me nenin 20 të KPPK-së, e dënueshme me nenet 28 dhe 179 (1.9) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tash e tutje në tekst “KPRK”);

i gjykuar në shkallën e parë nga Gjykata Themelore e Mitrovicës me aktgjykimin P. nr. 933/2013, të datës 10 korrik 2014 si në vazhdim:

Z.V. është shpallur fajtor dhe dënuar për veprën e ri-cilësuar penale të **Pengimit të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare në tentativë**, në kundërshtim me nenin 316 (1), (3), dhe (4) të KPPK-së dhe i liruar nga kryerja e veprës penale të vrasjes së rëndë në tentativë sipas nenit 364(1) të KPP-së sepse sipas vlerësimit të Gjykatës Themelore është gjetur se i pandehuri ka vepruar me dashje me qëllim për ta parandaluar kamionin që ishte nën ruajtje policore dhe i ngarkuar me naftë, që të shkonte në terminalin doganor në pjesën jugore të Mitrovicës dhe që t'i

nënshtrohej procedurës doganore. Megjithatë nuk është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i akuzuari e ka përdorur automjetin e vet si armë vdekjeprurëse me qëllim për të vrarë të dy policët ose që e ka parë mundësinë se mund t'i godas ata dhe se ata mund të ishin vrarë si pasojë e veprimeve të tija. Ai është dënuar me dënim unik prej dymbëdhjetë (12) muaj burgim duke iu llogaritur në dënimin e shqiptuar edhe koha e kaluar në paraburgim edhe në arrest shtëpiak; ndaj tij ishte caktuar për tu paguar shuma prej 300 euro si pjesë e shpenzimeve të procedurës penale.

duke vendosur përkitazi me ankesat në vazhdim të parashtruara kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës PKR nr. 933/2013 të datës 10 korrik 2014

- **ankesa e avokatit mbrojtës Nebojsa Vlajic në emër të të pandehurit Z.V., e parashtruar më 10 tetor 2014,**
- **ankesa e prokurorit të EULEX-it, e parashtruar më 13 tetor 2014,**

pas shqyrtimit të propozimit të prokurorit të apelit i parashtruar më 27 nëntor 2014;

pas mbajtjes së seancës publike të kolegjit të apelit më 20 korrik 2015;

pas mbajtjes së këshillimit dhe votimit më 20 korrik 2015;

në përputhje me nenet 389, 390, 394, 398 dhe 401 të KPP-së;

sjell këtë

AKTGJYKIM

- I. **Refuzohet si e pabazë ankesa e avokatit Nebojsa Vlajic për të pandehurin Z.V..**
- II. **Refuzohet si e pabazë ankesa e prokurorit të EULEX-it.**
- III. **Vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Mitrovicës nr. P 933/2013 i datës 10 korrik 2014.**

ARSYETIMI

I. HISTORIKU PËRKATËS I PROCEDURËS

Ngjarjet të cilat ndërlidhen me këtë lëndë penale kanë ndodhur pasdite vonë më 14 gusht 2010 në rrugën e Rudarit në mes të Zveçanit dhe Mitrovicës, afër kryqëzimit tek Manastiri Sokolica kur i pandehuri **Z.V.** duke shpërfillur shenjën e ngadalësimit dhe ndaljes të policit A.T., ka vazhduar të vozis motoçikletën katër rrotëshe me të njëjtën shpejtësi në drejtim të policëve A.T. dhe F.S. të cilët ishin duke e kryer detyrën e tyre zyrtare dhe të cilët mundën të shmangin përplasjen me automjetin që ishte duke ardhur vetëm në saje të lëvizjes me shpejtësi mënjane.

I pandehuri **Z.V.** është arrestuar dhe dërguar në paraburgim më 29 korrik 2013 e pastaj nga kjo datë deri më 28 shkurt 2014. Ndaj tij është caktuar masa e arrestit shtëpiak nga data 28 shkurt deri më 20 qershor 2014 kurse masa e paraqitjes në stacionin e policisë nga 20 qershor deri më 10 korrik 2014.

Prokurori i shtetit nga Zyra e Prokurorisë Themelore të Mitrovicës më 25 tetor 2013 ka ngritur aktakuzën PP. nr. 157/2013 të datës 24 tetor 2013 duke e akuzuar të pandehurin **Z.V.** për veprat penale të vrasjes së rëndë në tentativë në kundërshtim me nenin 147(10) të KPPK-së lidhur me nenin 20 të KPPK-së dhe mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve sipas nenit 374(1) të KPRK-së.

Shqyrtimi fillestar mbi aktakuzën është mbajtur më 13 nëntor 2013, në të cilën **Z.V.** e ka pranuar fajësinë për veprën penale të mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve dhe nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale të vrasjes së rëndë në tentativë. Me një aktvendim të lëshuar po të njëjtën ditë, akuza e mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve ishte ndarë nga procedura aktuale.

Shqyrtimi gjyqësor ishte caktuar të fillojë më 25 mars 2014 por procedura ishte shtyrë për shkak se ishin arrestuar të dy avokatët mbrojtës të të pandehuri. Ata janë dërguar nën masën e arrestit shtëpiak më 3 prill 2014. Kryetari i trupit gjykues e ka caktuar Nebojsa Vlajicin *ex officio* avokat mbrojtës për **Z.V.**in më 8 prill 2014.

Shqyrtimi gjyqësor në lëndë është mbajtur më 6 maj, 3, 4, 9, 10, 11, 18, dhe 19 qershor, dhe 9 korrik 2014, me këshillimet dhe votimin e mbajtur më 9 korrik 2014. Aktgjykimi u shpall më 10 korrik 2014.

Aktgjykimi me shkrim i është dorëzuar **Z.V.**it dhe mbrojtësit të tij më 26 shtator 2014 kurse prokurorit të EULEX-it më 29 shtator 2014. Përmes avokatit të tij mbrojtës, më 10 tetor 2014 **Z.V.**, e ka ankimuar këtë aktgjykim. Edhe prokurori i EULEX-it ka parashtruar ankesë kundër aktgjykimit më 13 tetor 2014. Prokurori i EULEX-it ka parashtruar përgjigje ndaj ankesës më 16 tetor 2014. Avokati mbrojtës i **Z.V.**it ka parashtruar përgjigje ndaj ankesës më 24 tetor 2014.

Lënda është transferuar në Gjykatën e Apelit për vendim mbi ankesën më 31 tetor 2014. Prokurori i apelit i shtetit ka parashtruar propozimin e tij më 27 nëntor 2014.

Seanca e Gjykatës së Apelit është mbajtur më 20 korrik 2015 në praninë e të dy palëve të dëmtuara A.T. dhe F.S.. I pandehuri **Z.V.** dhe avokati i tij mbrojtës Nebojsa Vlajic u ftuan sipas rregullit në seancë sikurse është vërtetuar me fletë dërgesa në shkresat e lëndës por asnjëri prej tyre nuk mori pjesë. As prokurori i apelit nuk ka marrë pjesë në seancë.

Kolegji i apelit është këshilluar dhe ka votuar më 20 korrik 2015.

I. PARASHTRESAT E PALËVE

Prokurori i EULEX-it Pascal Persoons më 13 tetor 2014 ka parashtruar në kohë ankesën e datës 13 tetor 2014 pranë Gjykatës Themelore për shkak të:

- Vërtetimit të gabueshëm të gjendjes faktike.
- Ri-cilësimi i veprës penale nga trupi gjykues nuk e pasqyron gjendjen faktike.

Prokurori i EULEX-it pohon se provat e administruara në gjykim provojnë se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Ai pohon se shpejtësia e lartë me të cilën i akuzuari po e ngiste automjetin e tij është vendimtare në vendosjen e cilësimit të drejtë juridik. Fakti i provuar se i akuzuari nuk ka shfaqur dashje për ta ngadalësuar ose ndalë automjetin e tij pavarësisht se i ka vërejtur qartë gjestet e policisë të njohura në mbarë botën dhe se ishte duke shkuar në drejtim të dy policëve pa e ndryshuar drejtimin e automjetit të tij, tregojnë gjendjen e tij mendore dhe vendosmërinë e tij për t'i goditur ata, ose së paku, ai e ka shpërfillur çfarëdo pasoje të mundshme të efektit në mes të automjetit të tij dhe policëve. Një aspekt tjetër kyç i fakteve të vërtetuara është se pa veprimin e dy palëve të dëmtuara respektivisht mënjanimin e tyre të shpejtë nga rruga për të shmangur përplasjen, ata do të ishin goditur nga motoçikleta me katër rrota. Përplasja është shmangur vetëm nga veprimet e policëve dhe jo nga veprimi i të akuzuarit. Provat e grumbulluara, si edhe të gjeturat e trupit gjykues tregojnë në mënyrë të qartë se i akuzuari e ka përdorur automjetin e vet si armë të mundshme vdekjeprurëse me qëllim të vetëm për t'i goditur dhe ndofta për t'i vrrarë dy policët gjatë kryerjes së detyrave së tyre zyrtare.

Prokurori i EULEX-it propozon që të ndryshohet aktgjykimi dhe të ruhet cilësimi fillestar i veprës penale.

Mbrojtësi Nebojsa Vlajic më 10 tetor 2014 ka parashtruar në kohë ankesën e datës 10 tetor 2014 për arsye të:

- Shkeljes së ligjit penal lidhur me vendimin mbi dënimin

Ai pohon se gjykata gabimisht e ka zbatuar nenin 20 paragrafi 1 të KPPK-së. Nga përkufizimi juridik i tentativës është e qartë se tentimi nënkupton ndërmarrjen e veprimeve të menjëhershme të cilat qojnë në kryerjen e një vepre penale. Po që se gjykata ka gjetur se i akuzuari “ka vepruar me dashje me qëllim të parandalimit të kamionit që ishte nën ruajtje policore dhe i ngarkuar me naftë që të shkonte në terminalin doganor në pjesën jugore të Mitrovicës dhe që t’i nënshtrohej procedurës doganore” atëherë gjykata do të kishte për të thënë se me çfarë veprim ai u përpoq për të parandaluar atë. Fakti se ai u ndal dhe donte të pyes për kamionin dhe ngarkesën në të nuk është tentim për ta kryer këtë vepër penale. Ajo çfarë bëri ai është thjeshtë çështje e kundërvajtjes në trafik kur vozitësi refuzon të ndalet ose vepër penale e rrezikimi të trafikut publik.

Në ankesën e tij mbrojtësi ka shtjelluar pse ai mendon se prokurori e ka akuzuar **Z.V.** me vrasje të rëndë në tentativë në procedurën e tanishme penale dhe sjellë akuza të tjera të pasuksesshme penale ndaj të akuzuarit që nuk ndërlidhen me këtë.

Më tej ai pohon se bile edhe nëse qëndron pengimi në tentativë i personave zyrtar, përsëri dënimi është shumë i ashpër. Ai përmend praktikën ligjore, se asnjëri në Kosovë që është shpallur fajtor për të njëjtën vepër penale nuk është dënuar asnjëherë me një vit burgim. Ai pohon se i akuzuari e ka marrë këtë dënim të rëndë sepse është serb nga pjesa veriore e Kosovës dhe është vëlla i një personi të caktuar. Për më shumë, ai i ka kaluar 11 muaj në paraburgim dhe për këtë arsye është dashur të dënohet aq ose edhe më shumë.

Mbrojtësi pohon se rrethanat lehtësuese dhe rënduese janë vërtetuar gabimisht nga trupi gjykes. Kolegji ka gjetur se nuk ka pasur rrethana lehtësuese, duke i neglizhuar plotësisht rrethanat personale të të akuzuarit, se është i martuar dhe ka dy fëmijë të vegjël dhe është i papunë. Po ashtu si rrethanë lehtësuese duhet të merret edhe bashkëpunimi dhe sjellja e tij gjatë procedurës. Për më tepër ai asnjëherë, e në veçanti, jo pas gushtit 2010, nuk ka pasur konflikt me policinë.

Sa u përket rrethanave rënduese, një faktor të cilin kolegji e ka marrë në konsideratë është skandaloz respektivisht se “vepra penale ka ndodhur në pjesën veriore të Kosovës, ku sundimi i ligjit akoma nuk është i pranishëm”. Rrethanë rënduese mund të jetë vetëm diçka që është brenda dashjes së kryerësit ose për të cilën ai mund të jetë përgjegjës. Përndryshe kjo do të qonte në diskriminim i cili ndalohet jo vetëm me traktate ndërkombëtare por edhe me kushtetutën e Kosovës.

Mbrojtësi propozon që të ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe të lirohet i akuzuari pasi që ai nuk ka kryer asnjë vepër penale.

Përgjigjet përkitazi me ankesën

Prokurorja e EULEX-it Neeta Amin ka parashtruar përgjigje ndaj ankesës së mbrojtësit Nebojsa Vlajic më 16 tetor 2014. Ajo thekson se prokuroria ka vështrim tjetër të lëndës nga ai i mbrojtjes dhe përsërit argumentet kryesore në ankesën e prokurorit.

Mbrojtës i të akuzuarit, avokati Nebojsa Vlajic po ashtu ka parashtruar përgjigje ndaj ankesës së prokurorit më 24 tetor 2014. Ai e konsideron ankesën e prokurorit të pabazë dhe propozon që e njëjta të refuzohet. Ai pohon se ankesa e prokurorit vetëm i përsërit arsyet të cilat kanë qenë të paraqitura nga prokurori në të gjitha fazat e procedurës dhe të cilat u vlerësuan nga gjykata në aktgjykim. Ajo që thotë prokurori nuk mbështetet nga dëshmitarët madje as nga palët e dëmtuara.

Propozimi i prokurorit të apelit

Në propozimin e tij të datës 27 nëntor 2014, prokurori i apelit Claudio Pala pajtohet me të gjeturat e trupit gjykues respektivisht se nuk është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri ka dashur të vras palët e dëmtuara duke pasur parasysh sjelljen e të pandehurit gjatë dhe pas kryerjes së veprës penale për të cilën ai është shpallur fajtor. Në vend të kësaj, faktet si janë provuara gjatë gjykimit qojnë në përfundimin se i akuzuari me dashje është përpjekur të pengojë policët në kryerjen e detyrës së tyre.

Sa i përket llogaritjes së dënimit, prokurori i apelit ia lë kolegjit të apelit vlerësimin nëse trupi gjykues e ka konsideruar në mënyrë të drejtë mungesën e rrethanave lehtësuese dhe nëse me të drejtë e ka konsideruar rrethanë rënduese situatën e cila nuk mund t'i ngarkohet të akuzuarit. Ai vëren se dënimi i shqiptuar në një rast të ngjashëm është i parëndësishëm në rastin konkret duke pasur parasysh rrethanat e ndryshme.

Prokurori i apelit shtyn Gjykatën e Apelit që të refuzojë ankesat si të pabaza dhe ta vërtetojë aktgjykimin e kundërshtuar.

II. GJETJET E KOLEGJIT

A. Kompetenca e kolegjit

Sipas nenit 472(1) të KPP-së, kolegji e ka shqyrtuar kompetencën e vet dhe pasi që nuk ka pasur asnjë kundërshtim nga palët kolegjit do t'i mjaftojë me sa vijon: në përputhje me Ligjin mbi gjykatat dhe Ligjin mbi kompetencat, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë - Ligji nr. 03/L-053 i ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-273, dhe i qartësuar përmes Marrëveshjes në mes të Shefit të EULEX-it në Kosovë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës të datës 18 qershor 2014, kolegji nxjerr konkluzionin se EULEX-i ka juridiksion mbi lëndën dhe se kolegji ka kompetencë për të vendosur përkitazi me lëndën aktuale që në përbërje të tij të ketë një gjyqtar të EULEX-it dhe dy gjyqtarë kosovar të apelit.

B. Pranueshmëria e ankesave

Aktgjykimi i kundërshtuar është shpallur më 10 korrik 2014 dhe është kryer më 10 shtator 2014. Aktgjykimi me shkrim i është dorëzuar **Z.V.**it dhe mbrojtësit të tij më 26 shtator 2014, kurse prokurorit të EULEX-it më 29 shtator 2014. Të gjitha ankesat janë parashtruar brenda afrit 15-ditësh në përputhje me nenin 380(1) të KPP-së. Të dy ankesat janë parashtruar nga personat e autorizuar dhe përmbajnë të gjitha informacionet sipas nenit 376 *et seq* të KPP-së. Për këtë arsye ato janë të pranueshme.

C. Gjetjet mbi çështjet meritore

Kolegji i apelit do t'i shqyrtojë të gjitha arsyet e ankesës të ngritura nën kapitujt e mëposhtëm përkatës. Së pari, kolegji do ta adresojë ankesën e prokurorit të EULEX-it mbi kundërshtimin e ri-cilësimit të veprës penale për të cilën i pandehuri ka qenë i dënuar. Së dyti, kolegji do t'i diskutojë kundërshtimet e ngritura në ankesë nga mbrojtësi Nebojsa Vlajic në emër të të pandehurit lidhur me shkeljen e ligjit penal sa i përket vendimit mbi dënimin.

Ankesa e prokurorit të EULEX-it

Gjykata e Apelit pajtohet me ri-cilësimin e veprës penale të miratuar nga Gjykata Themelore dhe vendos të refuzojë ankesën e prokurorit të EULEX-it si të pabazë.

Në kundërshtim me pohimin e prokurorit të EULEX-it, kolegji i apelit nuk konsideron se provat janë të mjaftueshme për të vërtetuar se **Z.V.** ka kryer vrasje të rëndë në tentativë dhe e ka shfrytëzuar automjetin e tij si armë vdekjeprurëse kundër dy policëve. Gjykata e Apelit pajtohet me vlerësimin e Gjykatës Themelore se dashje e të pandehurit për t'i vrarë palët e dëmtuara nuk ka qenë e vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm sikurse tregohet nga sjellja e tij gjatë dhe menjëherë pas kryerjes së veprës penale për të cilën ai është dënuar.

Sipas pikëpamjes së kolegjit, fakti se i pandehuri, edhe pse nuk e ka ngadalësuar shpejtësinë, ai as nuk e ka rritur atë derisa iu është afruar dy policëve të Kosovës,¹ dhe se e ka bërë një kthim në formë të shkronjës U dhe përsëri është kthyer prapa në mënyrë që të kuptojë çfarë po ndodhë me kamionin, tregon se dashja e tij ishte përqendruar në afrimin tek kamioni dhe ngarkesa që ndodhej në te e jo për të privuar nga jeta palët e dëmtuara.

¹ Ky fakt ka qenë i konfirmuar nga A.T. gjatë dhënies së dëshmisë së tij ndërsa F.S. ka sqaruar në gjykatë se nuk mund të jetë pozitivë për atë nëse ngasësi e ka rritur apo zvogëluar shpejtësinë e automjetit. *Shih* procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, 3 qershor 2014.

Kolegji i apelit konsideron se cilësimi juridik i veprës penale në “vrasje të rëndë në tentativë” nuk është vërtetuar dhe se Gjykata Themelore nuk ka gabuar në ri-cilësimin e veprës penale si “Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare”.

Ankesa e avokatit mbrojtës Nebojsa Vlajic në emër të Z.V.it

Lidhur me pohimin e të pandehurit se Gjykata Themelore ka gabuar në konstatimin se në fakt tentativa ka ndodhur, kolegji përkundrazi konsideron se veprimet e caktuara të ndërmarra nga **Z.V.** për kryerjen e veprës penale respektivisht fakti se ai ka vazhduar ta ngas motoçikletën e tij me katër rrotë në drejtim të policëve A.T. dhe F.S. dhe ka arritur ta futet në perimetrin e ndërtuar nga policia pavarësisht faktit se ata e patën urdhëruar të ngadalësojë shpejtësinë dhe të ndalet në përpjekje për ta parandaluar kamionin dhe ngarkesën e tij të kapet në terminalin doganor, janë paraqitur qartë në aktgjykim dhe të njëjtat kanë dalë nga provat. Në kundërshtim me pohimin e mbrojtjes, përveç dashjes, edhe *actus reus* i veprës penale ka ndodhur në mënyrë të qartë. Gjykata e Apelit është e kënaqur se është vërtetuar veprimi i menjëhershëm i ndërmarrë me dashje për kryerjen e veprës penale sipas nenit 20(1) të KPPK-së.

Përveç kësaj, parashtesa e avokatit mbrojtës se vepra penale përbën thjesht kundërvajtje në trafik është refuzuar si e pabazë duke pasur parasysh se provat e paraqitura në gjykim tregojnë se me veprimet e tij i pandehuri, ka pasur për qëllim të pengojë Policinë e Kosovës nga lëvizja e kamionit. Sipas pikëpamjes së Gjykatës së Apelit, kjo është konfirmuar më tej nga lidhjet e vërtetuara në mes të **Z.V.it** dhe kamionit me barrën e ngarkuar si edhe dijenia e të pandehurit se policët ishin duke vepruar në kapacitetin e tyre zyrtare.

Tentativa e veprës penale të “Pengimit të personave zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare” sipas nenit 316(1) të KPPK-së karakterizohet me përdorimin e forcës nga i pandehuri në mënyrë që ta thyej perimetrin e formuar nga forcat policore ashtu që t’i pengojë policët për ta dërguar kamionin në terminalin doganor.

Tani duke iu kthyer vendimit mbi dënimin, kolegji gjen se përmendja e mbrojtjes e rasteve të tjera gjoja të ngjashme është i parëndësishëm sepse rrethanat e secilës lëndë gjithsesi ndryshojnë. Prandaj çdo krahasim do të ishte i parëndësishëm në këtë aspekt.

Kolegji i apelit me kujdes i ka shqyrtuar rrethanat rënduese dhe lehtësuese të vërtetuara nga Gjykata Themelore si edhe kundërshtimet e ngritura në këtë drejtim në ankesën e të pandehurit. Kolegji e pranon pohimin e mbrojtjes se Gjykata Themelore nuk ka arritur të marr parasysh gjendjen familjare të të pandehurit kur ka konstatuar se nuk ekzistojnë rrethana lehtësuese në këtë lëndë.

Kolegji i apelit nuk gjen asnjë arsye për të mos besuar se gjendja familjare e të pandehurit e paraqitur nga mbrojtja është e saktë. Për këtë arsye kolegji i apelit e konsideron rrethanë lehtësuese për të pandehurin **Z.V.** se ai është i martuar dhe ka dy fëmijë të moshës jomadhore. Përveç kësaj, Gjykata e Apelit është e mendimit se duhet të merret parasysh si rrethanë lehtësuese fakti se i pandehuri ka bashkëpunuar gjatë procedurës.

Kolegji nuk pajtohet me pjesën në të cilën mbrojtja paraqet se fakti që vepra penale ka ndodhur në pjesën veriore të Kosovës – ku ende nuk është i pranishëm sundimi i ligjit – nuk mund të përbëjë rrethanë rënduese sepse nuk ishte pjesë e qëllimit të kryerësit. Kjo karakteristikë në mënyrë tipike është pjesë e asaj të cilën e përshkruan neni 64(1) i KPPK-së “rrethanat në të cilat është kryer vepra” e të cilat duhet të merren në konsideratë kur vendoset zbutja ose ashpërsimi i dënimit. Ndonëse mos sundimi i ligjit në pjesën veriore të Kosovës nuk mund t’i atribuohet të pandehurit, ai ka qenë i vetëdijshëm për gjendjen në veri dhe prapë se prapë e ka shfrytëzuar një ambient të tillë kur e ka kryer veprën penale. Kolegji i apelit konsideron se Gjykata Themelore në mënyrë të drejtë e ka konsideruar këtë si rrethanë rënduese dhe fuqishëm e refuzon si të pa mbështetur me prova pohimin për diskriminim në emër të Gjykatës Themelore për shkak të faktit se i pandehuri është serb i Kosovës nga pjesa veriore e vendit.

Në kuadër të rrethanave rënduese të vërtetuara në mënyrë të drejtë nga Gjykata Themelore dhe duke u kushtuar vëmendjen e duhur rrethanave të tjera lehtësuese të gjendjes familjare të të pandehurit dhe bashkëpunimin e tij gjatë procedurës, dhe duke pasur parasysh se dënimi maksimal i paraparë për veprën penale të pengimit të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare në tentativë është 3 vjet e 9 muaj burgim sipas neneve 20(3), 65(2) dhe 316(3) të KPPK-së të marra në kombinim, kolegji konsideron se dënimi prej një vit burgim i shqiptuar nga Gjykata Themelore nuk është jo proporcional dhe paraqet dënim të duhur sipas rrethanave të lëndës.

III. KONKLUZION

Për arsyet e shtjelluara më sipër, Gjykata e Apelit e refuzon ankesën e mbrojtjes dhe ankesën e prokurorit të EULEX-it dhe e vërteton aktgjykimin e kundërshtuar.

Përgatitur në gjuhën angleze, gjuhë e autorizuar, aktgjykimi i arsyetuar është kryer më 27 korrik 2015.

Kryetarja e kolegjit

Hajnalka Veronika Karpati
Gjyqtare e EULEX-it

Anëtari i kolegjit

Anëtarja e kolegjit

Xhevdet Abazi
Gjyqtar kosovar i Gjykatës së Apelit

Tonka Berishaj
Gjyqtare kosovare e Gjykatës së Apelit

Procesmbajtësja

Anne-Gaëlle Denier
Zyrtare ligjore e EULEX-it

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR 542/14
20 korrik 2015